VENDIM
Nr.44, datë 27.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i""
Manol Konomi,	Anëtar i""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Halil Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 31.7.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësoreme dyer të hapura çështjen nr.46 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT, e përfaqësuar nga kryetari Guri Durollari dhe avokat Kleanth Koçi.

2. PARTIA SOCIALDEMOKRATE,e përfaqësuar nga zoti Isak Spahiu

Person i interesuar: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga kryetari Kristaq Kumedhe zv/ kryetari Fatos Klosi.

O B J E K T I:

Për Partinë Lëvizja e Legalitetit:

Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1355, datë 13.7.1997 "Mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar të Referendumit", në bazë të nenit 18/1 të Lligjit nr.7866, datë 06.10.1994 "Për Referendumet"

2. Për Partinë Socialdemokrate: "Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve datë 13.7.1997 për rezultatet e shpallura nga komisioni i zgjedhjeve të zonës nr.2".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuesave dhe të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Më datë 29 qershor 1997 u zhvillua referendumi i përgjithshëm për formën e qeverisjes me alternativat: "Republikë" ose "Monarki Kushtetuese". Shpallja e rezultateve përfundimtare të referendumit u bë me vendimin nr.1355, datë 13.07.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilit ka fituar forma e qeverisjes "Republikë" me 904.359 vota ose 66,75 %.

Partia Lëvizja e Legalitetit ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar këto shkelje:

Procesi i votimit u karakterizua nga të meta serioze si para ashtu edhe gjatë votimit dhe veçanërisht në numurimin e votave; pati demonstrim force e përdorim armësh; ditën e votimit në shumë qendra mungonin listat e zgjedhësve e fletët e votimit; në shumë qendra votimi nuk janë numëruar votat - tipike është zona nr.75 Lushnje ku mungon plotësisht rezultati i referendumit; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pranon një sërë vërejtjesh esenciale dhe nuk i merr parasysh me arsyetimin se kanë ndikuar paanshmërisht si për Republikën edhe për Monarkinë; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shpallur rezultatin me 8 vota pro e 6 kundër; janë shkelur disa nene të Ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 "Për Referendumet" - të rënda janë shkeljet e neneve 23 e 27.

Në seancë gjyqësore, kërkuesi, veç sa sipër, parashtron edhe këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve :

Zhvillimi i referendumit në të njëjtën ditë me gjedhjet për deputetët e Kuvendit Populllor ishte

një gjetje e gabuar e cila solli si rezultat shkelje ligjore të rënda, ka patur demonstrime me armë, mungesë të dokumentacionit, procesverbale pa firmë, me korrigjime etj., pranohet se janë shpërndarë fletë votimi aq sa ka qenë numuri i përgjithshëm i shtetasve të regjistruar për votim, kur në bazë të nenit 23 të ligjit duhet 2 % më shumë; ne kemi pretenduar e vërtetuar se nuk janë shpërndarë disa qindra - mijë fletë votimi; nuk mund të bëhen arsyetime me përafërsi për pasojat dhe të quhen të rënda kur dëmtohet njëra alternativë dhe të lehta kur dëmtohen të dy alternativat; ndryshimi i mënyrës së votimit për referendumin pa u ndryshuar ligji, është arbitrar. Po të zbatohet kërkesa e ligjit, rezultati përmbyset. Ne nuk pretendojmë për këtë përmbysje por kemi të drejtë të themi se jemi para një procesi zgjedhor të paligjshëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në bazë të nenit 1/2 të Dekretit nr.1808, datë 06.06.1997, Partia Lëvizja e Legalitetit, njihet si "nismëtare e referendumit", prandaj me këtë cilësi ajo legjitimohet për të bërë kërkesë. Gjithashtu, kërkuesi është brenda afatit ligjor të ankimit për faktin se Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është njoftuar më datë 14 korrik 1997 dhe kërkesën e ka paraqitur në 16 korrik 1997.

Para se t'i hyjë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata thekson se procesi i referendumit për formën e qeverisjes është paraprirë dhe bazuar në një sërë dispozitash ligjore, që përcaktojnë kushtet dhe procedurat e zhvillimit të referendumeve. Kështu, sipas nenit 3 të Ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", "Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij si dhe me referendum". Në nenin 16/7, ndër kompetencat kryesore të Kuvendit Popullor, përcaktohet se "vendos për referendumet popullore". Ndërsa neni 28/4 përcakton se Presidenti i Republikës "Shpall ligjet dhe referendumet e vendosura nga Kuvendi Popullor". Në mbështetje të këtyre neneve të ligjit kushtetues, Kuvendi Popullor ka miratuar Ligjin nr.7866, datë 6.10.1994 "Për referendumet", i cili parashikon procedurat për organizimin dhe zhvillimin e referendumeve. Për referendumin e datës 19 qershor 1997, Kuvendi Popullor në mbështetje të nenit 16 pika 7 të ligjit themelor, me Vendimin nr.310, datë 13.5.1997 ka vendosur thirrjen e referendumit të përgjithshëm për formën e qeverisjes, republikë ose monarki kushtetuese, në të njëjtën ditë me zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor. Ndërsa Presidenti i Republikës me Dekretin nr.1798, datë 21.5.1997 ka shpallur referendumin e vendosur nga Kuvendi Popullor.

Sa sipër Gjykata çmon se caktimi i referendumit për formën e qeverisjes më datë 29 qershor 1997 është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Kërkuesi e konsideron shkelje të rëndë dhe të patolerueshme ndryshimin e mënyrës së votimit për referendumin pa u ndryshuar ligji dhe pretendon se jemi para një procesi zgjedhor të paligjshëm. Duke shqyrtuar këtë pretendim Gjykata konstaton se mënyra e votimit nuk është bërë sipas nenit 27 të Ligjit nr.7866, datë 06.10.1994 "Për referendumet", por sipas mënyrës së caktuar në ligjin për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit Popullor. Në nenin 27 të ligjit për referendumet thuhet se: "Shtetasi që voton le pa prekur atë alternativë në favor të së cilës është, duke i vënë vizë alternativës tjetër". Në fakt votimi dhe numërimi i votave është bërë në mënyrë tjetër duke u quajtur kundër alternativa e paprekur dhe pro ajo që është prekur. Por, duke analizuar në tërësi këtë fakt, Gjykata çmon se ndodhemi para një moszbatimi formal të kërkesës së ligjit që nuk ka sjellë ndonjë pasojë. Përkundrazi, pavarësisht nga ndryshimi i mënyrës së votimit, duke u njësuar kjo me atë të zgjedhjes së deputetëve, votuesit e kanë shprehur drejt vullnetin e tyre për alternativën që kanë dëshiruar. Kjo për faktin se përveç sqarimeve paraprake e të vazhdueshme në masmedia, procedura e votimit ka qenë e tillë që çdo votuesi iu dhanë dy fletë votimi, një për deputetët dhe një për referendumin duke iu sqaruar edhe mënyrën e njëjtë të votimit. Eshtë pikërisht kjo mënyrë e njëjtë votimi që garanton shprehjen e vullnetit të drejtë të shtetasve, gjë që nuk mund të thuhet në rast se mënyrat e votimit do të ishin të ndryshme.

Përsa i përket pretendimit tjetër se është shkelur neni 23 i ligjit sepse nuk janë shpërndarë fletë votimi në masën 2 % më shumë se numri i përgjithshëm i shtetasve të regjistruar për votim, që është 1.986.550, Gjykata çmon se ky nuk duhet të merret në konsideratë për faktin se numri i shtetasve që kanë marrë pjesë në votime është 1.423.209, pra fletë votimet e shpërndara e kalojnë ndjeshëm numrin e votuesve.

Për mënyrën e marrjes së vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të cilën kërkuesi e konsideron të parregullt, Ligji "Për referendumet" nuk shprehet, por Gjykata çmon se vendimi është marrë në mënyrë të rregullt me shumicë të thjeshtë votash.

Pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi kanë të bëjnë me shkelje e parregullsi gjatë

procesit të votimit për referendumin, të cilat janë analizuar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky i fundit ndonëse i pranon ato, shprehet në vendim se "natyra dhe madhësia e këtyre parregullsive ka një ndikim të vogël në normalitetin e referendumit, ndikim që influencon paanshmërisht si për Republikën ashtu edhe për Monarkinë".

Lidhur me këtë përfundim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe pretendimet e kërkuesit, Gjykata çmon se rëndësi ka fakti se në ç'madhësi janë parregullsitë dhe sa ndikojnë ato në rezultatin përfundimtar. Në këtë kuptim, në rast se për shkeljet e pretenduara dhe të njohura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të merreshin në favor të Monarkisë të gjitha votat e mundshme, përsëri kjo nuk ndikon në rezultatin përfundimtar, sepse shuma e tyre nuk i kalon 6 %.

Në këto rrethana, kërkesa e paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin të pavlefshëm të procesit të referendumit, nuk është e bazuar.

Gjykata mori në shqyrtim edhe kërkesën e Partisë Socialdemokrate, e cila kërkon të shfuqizohet Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1371, datë 16.7.1997, që ka lënë në fuqi vendimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.2 në favor të Monarkisë si dhe të përsëritet votimi për referendumin në këtë zonë. Si shkak për këtë kërkuesi parashtron se rezultatet e votimit në këtë zonë janë të manipuluara, procesi zgjedhor është bërë me parregullsi të mëdha dhe se procesverbali i zonës është bërë pa procesverbalet e qendrave të votimit duke i improvizuar ato. Gjatë gjykimit kërkuesi nuk paraqiti prova për të vërtetuar pretendimet që parashtron, prandaj kjo kërkesë duhet të rrëzohet si e pabazuar.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatet e referendumit për formën e qeverisjes, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.7866, datë 6.10.1994 “Për referendumet”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesave.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi mënjëherë.